



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

óEfektiviteti i politikave mjedisore në Njësitë e
Vetëqeverisjes Vendoreô



Tiranë, Qershor 2022

P Ë R M B A J T J A	Faqe
1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT.....	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	5
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	6
2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM.....	7
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	10
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	12
2.4 Pësia në buxhet.....	13
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	18
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	20
2.7 Feedback-u i subjektit përgjatë gjithë auditimit.....	21
3. DETAJET E AUDITIMIT.....	21
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	22
3.2 Objektivi i auditimit.....	23
3.3 Pyetjet e auditimit.....	24
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	25
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....	25
4.1 A janë hartuar politikat e duhura mjedisore nga NJVQV?	25
4.2 A rezulton pozitive dinamika e politikave të ndërmarra nga NJVQV?	34
5. PËRMBLEDHJE.....	40
6. SHTOJCAT.....	41
7. GRUPI I PUNËS.....	41

LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
DRM	Drejtoritë Rajonale të Mjedisit
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
RGJM	Raport i Gjendjes në Mjedis
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>International Standards of Supreme Audit Institutions</i>)
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit të Bashkisë

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL


Mjedisi jetësor është një e mirë e përgjithshme, succesio për tërë njerëzimin dhe botën e gjallë, duke i përfshirë bimët dhe shtazët. Mjedisi jetësor është toka, uji, ajri, në të gjithë pjesët e botës. Është *res communis omnium*, pra është e imja, e jotja, edhe e atyre që do të vinë pas nesh. Është *jus divinum*, kemi të drejtë ta shfrytëzojmë deri në atë pikë sa të mos shkelim të drejtat e tij, kemi obligim që ta mbrojmë dhe bartim përgjegjësi nëse e dëmtojmë.

Zhvillimi i vrullshëm ekonomik i botës e civilizimi i saj, krahas progresit të madh që kanë sjellë në jetën sociale e ekonomike, në të njëjtën kohë ka ndikuar edhe në ndotjen e mjedisit ku ne jetojmë.

Sot, mjedisi në vendin tonë paraqitet shumë i ndotur me produkte e mbeturina të shumëllojshme, ndër to vendin kryesor e zënë mbetjet urbane, kimike, emetimi i gazrave në hapësirë dhe industrive të ndryshme që operojnë, zhurmat dhe kaosi përbëjnë një ndotës tjetër që ndikon dukshëm në gjendjen emocionale dhe psikologjike duke dëmtuar ndjeshëm cilësinë e jetës.

Veprimet e njeriut, ndonëse kanë qëllime primare zhvillimin dhe përparimin, shpeshherë paraqesin edhe burime ndotëse. Të tilla janë: teknologjia e shpejtë dhe e përparuar, shtimi i madh i popullsisë, industrializimi, shtimi i gazit karbonik (CO₂) dhe i gazrave të tjera óserô në atmosferë, prerja e pyjeve, ndotësit e ndryshëm të rinj që përdoren gjatë kultivimit të tokës dhe detit, etj, paraqesin kërcënim serioz për sistemin klimatik dhe të ekosistemit.

Me ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit, dëmtohen e gradualisht shkatërrohen ekosistemet dhe habitatet natyrore të kafshëve dhe bimëve.



Diskutimi në lidhje me mbrojtjen e mjedisit përveçse detyrim i çdokujt, përqëndrohet fort në rolin e qeverisë, legjislacionit dhe zbatimit të ligjit.

Vendimet që ndikojnë në mjedis do të përfshijnë në mënyrë ideale një gamë të gjerë të palëve të interesuara, përfshirë industrinë, grupet indigjene, grupet e mjedisit dhe përfaqësuesit e komunitetit.

Gjatë viteve të fundit janë zbatuar një sërë projektesh me financim të huaj dhe nga buxheti i shtetit për studime të ndryshme fizibiliteti, për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit, hartimin e dokumenteve strategjike për menaxhimin e burimeve natyrore, të zonës bregdetare e të tjera. Megjithatë, mbështetja financiare nga buxheti i shtetit për sektorin e mjedisit është akoma e kufizuar. Shkalla e ndërgjegjësimit mjedisor të publikut dhe të komunitetit të biznesit nuk është ende në nivelin e duhur. Roli i organizatave jofitimprurëse mjedisore, edhe pse është rritur në mënyrë të ndjeshme nga viti në vit, nuk ka ndikimin e duhur në jetën publike dhe politike të vendit. Ngritja e strukturave vendore për mbrojtjen e mjedisit përbën një arritje të rëndësishme, veçanërisht po të merret parasysh që trashëgimia institucionale dhe ligjore në këtë fushë ka qenë e ulët.

Por duke qenë se problemet mjedisore janë specifike dhe të veçanta, në varësi të vendndodhjes gjeografike, roli i zbatimi i strategjive/planeve të veprimit në mënyrë të decentralizuar është vendimtar. Pikërisht decentralizimi i vendim-marrjes (delegimi i funksioneve nga qeverisja qendrore në atë vendore) ka qenë një hap efektiv për adresimin e problemeve mjedisore.

Duke parë përpara, perspektivat për uljen e rreziqeve mjedisore për shëndetin do të përmirësohen vetëm me integrimin më të mirë të politikave mjedisore dhe shëndetësore.¹

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performancë. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022 për auditimet e performancës, si: *fokusimi në çështje makro-ekonomike, krahas atyre mikro-ekonomike apo fokusimi në auditime procesi më shumë sesa auditime institucioni*², etj., KLSH ndërmori auditimin e Efektiviteti i politikave mjedisore në NJVQV², duke konsideruar mjedisin si një ndër çështjet dhe problematikat me të cilat shoqëria përballet çdo ditë. KLSH nëpërmjet këtij auditimi

¹ Raporti i gjendjes së mjedisit jetësor në Evropë- SOER 2020

² Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022 KLSH, fq. 39

synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me politikat mjedisore dhe efektivitetin e tyre, si dhe të japë rekomandime për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij audituese gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe atyre vendore sa i përket mbrojtjes dhe përkujdesjes për mjedisin. Roli i këtyre institucioneve si dhe koordinimi i tyre në mënyrë të veçantë në fushën mjedisore ka qenë jo në nivelin e kërkuar dhe ka evidentuar në vazhdimësi problematika.

KLSH nëpërmjet Departamentit të Performancës por jo vetëm, përgjatë periudhës viti 2017 dhe në vijim ka kryer një sërë auditimesh të cilat lidhen me mjedisin dhe mbrojtjen e tij. Gjetjet dhe konkluzionet e dokumentuara të auditimeve të zhvilluara në fushën mjedisore i janë paraqitur Kuvendit të Shqipërisë, mediave dhe mbi të gjitha publikut.

Gjatë vitit 2017, KLSH ka realizuar:

- ✓ Auditim performance me temë *“Cilësia e Ajrit”*, i ushtruar në subjektet, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare të Mjedisit, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Instituti i Shëndetit Publik, si dhe në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Berat, Drejtorinë Rajonale Shëndetësore Berat.
- ✓ Auditim performance me temë *“Ruajtja e Ekosistemit të Parkut Kombëtar të Prespës”*, i ushtruar në subjektet, Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Bashkia e Pustecit dhe Bashkia e Devollit, për periudhën e aktivitetit 2012 në 2016.

Gjatë vitit 2018, KLSH ka realizuar:

- ✓ Auditim performance me temë *“Funksionimi i Bashkive në Kuadër të Reformës Administrative-territoriale”* i ushtruar në subjektet: Bashkia Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Fier e Dropull, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Financave Vendore) dhe Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore (në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme). Në këtë auditim janë trajtuar edhe disa nga funksionet e reja të transferuara tek Njësitë e Qeverisjes Vendore mbi administrimin/mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave.
- ✓ Auditim performance me temë *“Menaxhimi i Përpunimit të Mbetjeve të Ngurta në Impiantin e Bashkisë Fier”* i ushtruar në subjektet: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier.

Gjatë vitit 2019, KLSH ka realizuar:

- ✓ Auditim performance me temë *“Ndotja e deteve”* i ushtruar në subjektet: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Agjencia Kombëtare të Bregdetit; Agjencia Kombëtare të Mjedisit.
- ✓ Auditim performance me temë *“Ndotja Akustike”* i ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Institutin e Shëndetit Publik dhe Bashkinë Tiranë.
- ✓ Auditim performance me temë *“Efektiviteti i menaxhimit dhe administrimit të fondit pyjor dhe kullor”* i ushtruar në subjektet: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet në varësi të saj, Bashkia Tiranë, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Shkodër.

Gjatë vitit 2020, KLSH ka realizuar:

- ✓ Auditim performance me temë *“Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut”* i ushtruar në subjektet: Ministria e Mbrojtjes/Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile e cila ka

marrëdhënie me Sektorët e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në 12 prefekturat e vendit.

Gjatë vitit 2021, KLSH ka realizuar:

✓ Auditim performance me temë *“Pastrimi i Qytetit”* i ushtruar në Bashkinë Vlorë.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Bashkia Tiranë;
2. Bashkia Vlorë;
3. Bashkia Fier;
4. Bashkia Lezhë;
5. Bashkia Shkodër;
6. Bashkia Pogradec;
7. Bashkia Korçë.

Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore në fushën e mbrojtjes së mjedisit në nivel vendor rregullon organizimin dhe funksionimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse, si më poshtë.

- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi³;
- Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura;
- Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake⁴;
Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:
- Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja;
- Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike;
- Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit⁵.

Bashkitë janë përgjegjëse për Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi⁶.

Ligji nr.10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Autoritetet publike që kanë detyrimin për mbrojtjen e mjedisit janë: Organet e qeverisjes qendrore, organet e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe çdo person fizik apo juridik, që ka përgjegjësi a funksione administrative publike/funksione publike, detyra e veprimtari apo që siguron shërbime publike, që kanë të bëjnë me mjedisin⁷.

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si institucioni kryesor i organeve të qeverisjes qendrore përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare në

³ Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 9 "të drejtat dhe përgjegjësitë"

⁴ Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 23 pika 2,10 "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike"


⁵ Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 26 "Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit"

⁶ Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 27 pika 5,6 "Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve e kullotave publike, natyrës e biodiversitetit"

⁷ Ligji nr.10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" neni 5 pika1/a,b,c

mënyrë periodike; Ministria, sipas rastit, përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit; Strategjitë dhe planet rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave; Këshilli i Ministrave miraton strategjitë dhe planet mjedisore kombëtare⁸.

- Autoritetet e Vetqeverisjes Vendore/Bashkitë përgatisin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji; Planet e veprimit vendore për mjedisin, rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave; Këshilli i autoritetit të qeverisjes vendore përkatëse miraton planet e referuara në pikën 1 të këtij neni; Kryetarët e Njësive të Vetqeverisjes Vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në Këshillin e Qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës⁹.



Ligji nr.10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet: parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre; pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

- Kryetarët e Njësive të Vetqeverisjes Vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji¹⁰.

Ligji nr.9244/2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" i ndryshuar, ka për qëllim: të përcaktojë parimet, rregullat dhe institucionet për ruajtjen dhe përmirësimin në mënyrë të qëndrueshme të funksioneve që përmbush toka bujqësore dhe, ne veçanti, pjellorinë e saj; të harmonizojë të drejtat dhe përfitimet, që rrjedhin nga pronësia mbi token bujqësore, me detyrimet dhe përgjegjësitë për

⁸ Ligji nr.10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" neni 21 "Strategjitë dhe Planet mjedisore"

⁹ Ligji nr.10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 22 pika 1,2,3,4 "Planet vendore të veprimit të mjedisit"

¹⁰ Ligji nr.10463/2011 "Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve" neni 21 pika 12 "Përgjegjësitë për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

mbrojtjen dhe përdorimin e saj të qëndrueshëm; të ruajë dhe të rehabilitojë tokën bujqësore nga veprimi i dëmshëm i faktorëve të ndryshëm klimatikë dhe njerëzorë.

Ligji 8752/2001 i ndryshuar me Ligjin nr.10257/2010 "Për Krijimin dhe Funkcionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës" ka për qëllim të përcaktojë rregullat themelore të administrimit të tokës bujqësore, në pronësi private dhe shtetërore dhe të disa prej kategorive të tjera të resurseve; strukturat shtetërore pranë qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tokës, si dhe funksionet e detyrat e tyre."

- Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) menaxhon dhe merr masa për mbrojtjen e tokës në territorin brenda ndarjes administrative territoriale të komunës dhe/ose bashkisë¹¹;
- Përgjigjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, në pronësi shtetërore dhe në pronësi private, si dhe të kategorive të resurseve të tjera;
- Mban dhe ruan me inventarizim dokumentacionin kadastral ekzistues, që ka për objekt kategoritë e resurseve në juridiksion të saj;
- Të zbatojë vendimet dhe urdhëresat e këshillit të qarkut dhe KMT-së, që kanë si objekt territorin e komunës ose bashkisë;

Bazuar në dokumentacionin kadastral ekzistues dhe dokumentacionin e ri kadastral, që grumbullohet dhe sistemohet, plotëson ÓRegjistrin e tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve¹².

Ligj Nr. 107/2014 ÓPër planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar ka për qëllim të sigurojë:

- Zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore; mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet; garantimin e burimeve të furnizimit të mjaftueshëm dhe veçanërisht atij jetësor;
- Garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
- Të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;
- Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit në nivel bashkie janë: *këshilli bashkiak dhe kryetari i bashkisë*.

Ligji Nr. 162/2014 ÓPër mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedisó ka për qëllim të përmirësojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet integritetit të çështjes së mbrojtjes së ajrit në politika të tjera, si dhe përcaktimit të kërkesave për pakësimin e shkarkimeve, monitorimin, vlerësimin, planet e cilësisë së ajrit, dhe për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për këtë qëllim.

- Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për masat që duhen marrë në kuadër të legjislacionit të tyre të posaçëm, të cilat çojnë në ruajtjen ose përmirësimin e cilësisë së ajrit¹³;

¹¹ Ligji nr.8752/2001 " Për Krijimin dhe Funkcionimin e Strukturave për Administrimin Dhe Mbrojtjen e Tokës" neni 6,10

¹² VKM nr.121/2011 " Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga DAMT në Qarqe dhe ZMMT në Komuna dhe/ose Bashki" kreu IV

¹³ Ligj Nr. 162/2014 ÓPër mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedisó neni 4 pika 3 "Autoritetet kompetente"

Autoritetet e përmendura në pikat 8, 9 dhe 10, të nenit 7, të këtij ligji, pra përfshirë dhe Bashkitë duhet të përgatisin dhe të zbatojnë planin e veprimit afatshkurtër në çdo rast kur në ndonjë zonë ose aglomerat ekziston rreziku që nivelet e ndotësve të kapërcejnë një apo më shumë nga pragjet e alarmit, të përcaktuar sipas vendimit të referuar në nenin 5 të këtij ligji¹⁴.

Ligji Nr. 9103, Datë 10.07.2013 óPër mbrojtjen e liqeneve ndërkufitarë (i ndryshuar) ka për qëllim mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare.

- NJVQV kanë për detyrë hartimin dhe zbatimin e planeve vendore për rehabilitimin e pjesëve të ndotura e të dëmtuara të liqeneve ndërkufitare;
- Kontrollin e vazhdueshëm për të siguruar ruajtjen e gjendjes natyrore të liqeneve ndërkufitare dhe të faunës e florës së tyre¹⁵;
- Policia bashkiake në bashkëpunim me disa institucione të tjera ushtron kontroll në zonat e liqeneve ndërkufitare të cilat kanë statusin e zonave të mbrojtura¹⁶.

Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, óPër vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedisë ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma.

Organet e Vetqeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre:

- Drejtojnë hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshillat e bashkive/komunave; drejtojnë procesin e hartëzimit të zhurmës;
- Shpallin zona të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosin kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit;
- Kërkojnë nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës¹⁷;
- Struktura përgjegjëse për kontrollin e mjedisit të bashkisë në bashkëpunim me organe të tjera kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij¹⁸;
- Inspektori i strukturës përgjegjëse për kontrollin e mjedisit të bashkisë që bën kontrollin merr vendimin dhe masa në përputhje me ligjin për inspektimin¹⁹.

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Ligji Nr. 154/2014, *óPër organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të Shtetit*;
- Strategjia Ndërsektorale e mjedisit 2013-2020;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI 2015-2020;
- Strategjia Kombëtare për Mbetjet dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve;
- Programi i Qeverisë për Mjedisin 2017-2021;
- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit";
- Ligji nr.10119 datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e territorit" i ndryshuar me Ligjin nr. 107/2014, óPër planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve";
- Ligji Nr. 8094, datë 21.3.1996 óPër largimi publik të mbeturinave;

¹⁴ Ligj Nr. 162/2014 óPër mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedisë neni 8 pika 1,2,3,4,7 "Planet e veprimit afatshkurtër"

¹⁵ Ligji nr. 9103, Datë 10.07.2013 óPër mbrojtjen e liqeneve ndërkufitarë (i ndryshuar) neni 5 pika c,f

¹⁶ Ligji nr. 9103, Datë 10.07.2013 óPër mbrojtjen e liqeneve ndërkufitarë (i ndryshuar) neni 21 pika 3

¹⁷ Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, óPër vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedisë neni 8

¹⁸ Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, óPër vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedisë neni 29

¹⁹ Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, óPër vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedisë neni 30 pika 1,2,3

- Ligji nr.162/2014 "Për Mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis";
- Ligji nr.9774 datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" i ndryshuar me Ligjin nr.39/2013;
- Ligji nr. 9115 datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura";
- Ligji nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore";
- Ligji Nr. 8752, datë 26.3.2001 óPër krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokësó, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9244 datë 17.6.2004 óPër mbrojtjen e tokës bujqësoreó, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 óPër pyjet dhe shërbimin pyjoró, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 óPër fondin kullosoró, i ndryshuar me Ligjin nr.38/2013;
- Ligji Nr. 5/2016, datë 4.2.2016 óPër shpalljen e moratoriumit në pyjeó;
- Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 óPër mbrojtjen e biodiversitetitó, i ndryshuar
- Ligji Nr. 81 datë 04.05.2017 óPër zonat e mbrojturaó;
- Ligji Nr. 8905, datë 6.6.2002 óPër mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimió, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9362, datë 24.3.2005 óPër shërbimin e mbrojtjes së bimëveó;
- Ligji Nr. 91 datë 28.02.2013 óPër Vlerësimin Strategjik Mjedisoró;
- Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 óPër vlerësimin e ndikimit në mjedisó;
- VKM Nr. 73, datë 7.2.2018 óPër Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018-2027ó;
- VKM Nr. 1096, datë 28.12.2015 óPër miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publikeó;
- VKM Nr. 633, datë 26.10.2018 óPër masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjeteó;
- VKM Nr. 908, datë 21.12.2016 óPër përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalimeó;
- VKM Nr. 352, 29.04.2015, óPër vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me tëó;
- VKM Nr. 246, 30.04.2014 óPër përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësoreó;
- Udhëzim Nr. 8, datë 27.11.2007 óPër nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuaraó;
- VKM Nr. 121 datë 17.02.2011 óPër mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashkió;
- VKM Nr. 814, datë 31.12.2018 óPër miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019-2030ó;
- VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 óPër transferimin në pronësi të pyjeve dhe kullotave, bashkiveó;
- VKM Nr. 22, datë 09.1.2008 óPër përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunaló;
- VKM Nr. 31, datë 20.1.2016 óPër miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetitó;
- VKM Nr. 762, datë 16.9.2015 óPër miratimin e dokumentit për përcaktimin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatikeó;

- VKM Nr. 814, datë 31.12.2018 óPër miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019-2030ó;
- VKM nr.178/2012 "Për incenerimin e mbetjeve";
- Plani i Mbrojtjes së Biodiversitetit në Bashkia Shkodër;
- Plani për veprimin e zhurmave në mjedis, Bashkia Shkodër;
- Programet e Mbrojtjes së Mjedisit 2018-2019-2020, Bashkia Shkodër;
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor 2016, Bashkia Shkodër;
- Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit, Bashkia Shkodër;
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor 2016 në Bashkia Korçë;
- Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit, Bashkia Korçë;
- Projekt Pastrimi 2018-2020, Bashkia Korçë;
- Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit 2021- Bashkia Pogradec;
- Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit në Bashkia Vlorë;
- Politika Mjedisore për pyjet, Sektori Pyje e Kullota, Bashkia Vlorë;
- Marrëveshje Nënhuaje "Programi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta" 2017, Bashkia Vlorë;
- Strategjia e zhvillimit të qendrueshëm 2018-2020 në Bashkia Tiranë;
- Plani i Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane 2020, në Bashkia Tiranë;
- Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit 2019, Bashkia Tiranë;
- Plani i Veprimit óQyteti i Gjellbëró 2018, në Bashkia Tiranë.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, NJVQV janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve në fushën e mjedisit:²⁰

- ✓ Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
- ✓ Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
- ✓ Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit kanë këto përgjegjësi:²¹

- ✓ Administrimin, shfrytëzimin dhe mirë-mbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- ✓ Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- ✓ Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi.
- ✓ Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.
- ✓ Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi.
- ✓ Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Në zbatim të Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 gjatë procesit të planifikimit²²

²⁰ Neni 26 Ligji Nr.139/2015 Për vetëqeverisjen vendore

²¹ Neni 27 Ligji Nr.139/2015 Për vetëqeverisjen vendore

- ✓ Autoritetet e qeverisjes vendore përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji.
- ✓ Planet e veprimit, vendore, për mjedisin rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave.
- ✓ Këshilli i autoritetit të qeverisjes vendore përkatëse miraton planet e referuara në pikën 1 të këtij neni.
- ✓ Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.

2.4 Pësja në buxhet

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore referuar disiplinës buxhetore parashikojnë fonde të veta për përmbushjen e funksioneve të veta ku përfshihen dhe ato funksione që kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit mbi territorin e tyre, ndërkohë për disa funksione të transferuara në nivel vendor prej vitit 2016, NJVV përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, kjo në formën e transfertës së pakushtëzuar e cila miratohet si pjesë integrale e buxhetit vjetor të shtetit. Është pikërisht pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar e cila përfshin financimin për disa funksione të transferuara mes të cilave janë Administrimi i Pyjeve dhe Ujitja që lidhen me mjedisin. Fondet e transfertës kanë të bëjnë me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore të punonjësve si dhe për shpenzime operative.

Për auditimin e Efektivitetit të politikave Mjedisore në NJVV, grupi i auditimit ka marrë dhe shqyrtuar të dhëna nga subjektet e audituara mbi buxhetet e planifikuara dhe realizimet e tyre duke evidentuar ato programe buxhetore që lidhen kryesisht dhe drejtpërdrejtë me çështjet e mjedisit. Për këto programe, vlerat financiare dhe pjesa që zënë në buxhetin vjetor paraqiten si më poshtë:

Tabela Nr. 1 Treguesit financiarë për mjedisin në Bashkinë Tiranë

Në mijë lekë


Zërat	Kodi i prog.	Emertimi	2018		2019		2020		2021	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan vjetor	Fakt 6-mujori 1-re
1	04240	Menaxhimi i infrastruktures ujitjes dhe kullimit	106,370	42,826	83,974	48,579	55,825	20,393	57,073	814
2	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	11,350	10,383	10,017	9,370	9,696	9,009	10,643	1,635
3	05100	Menaxhimi i mbetjeve					2,195,956	1,976,106	2,415,340	735,082
4	05320	Programet e mbrojtjes se mjedisit								
5	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor								
6	04970	Programi i Zhvillimit Ekonomik, Vendor, Rural dhe Pyje	207,690	85,471	316,881	128,571				
7	06260	Pastrimi i qytetit	1,632,403	1,462,116	1,490,374	1,382,651				
		Shpenzime për landfillin e Sharres per projektin e inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese ne Tiranë	224,000	224,000	477,125	477,125				
Shuma			2,181,812	1,824,796	2,378,370	2,046,296	2,261,478	2,005,507	2,483,056	737,531
Buxheti total vjetor i Bashkisë			25,477,622	19,811,958	26,188,436	21,776,156	23,635,769	18,109,529	23,211,097	6,960,618
Pjesa që mjedisi zë në buxhetin faktik (%)				9.2%		9.4%		11.1%	10.7%	

Burimi informacionit: Bashkia Tiranë

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

²² Neni 22 Ligji Nr. 10431 datë 09.06.2011, Planet vendore për mbrojtjen e mjedisit

Grafiku Nr. 3 Raporti fonde për mjedisin kundrejt buxhetit total.



Punoi: Grupi i Auditimit

Referuar treguesve më sipër evidentohet se nivelet faktike të shpenzimeve të kryera që lidhen me mjedisin në raport me buxhetin total shkojnë deri në 11.1% të tij. Sa i përket programeve të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin mjedisor në këto zëra nuk rezultojnë të ketë patur buxhetim dhe rrjedhimisht as realizim të tij.

Tabela Nr. 2 Treguesit financiarë për mjedisin në Bashkinë Lezhë:


Në mijë lekë

Zërat	Kodi i prog.	Emertimi	2018		2019		2020		2021	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan vjetor	Fakt 6-mujori I-re
1	04240	Menaxhimi i infrastruktures ujitjes dhe kullimit	27,989	27,989	31,487	27,212	58,003	43,472	68,646	43,632
2	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	20,076	17,894	22,603	19,676	16,294	15,002	16,500	6,248
3	05100	Menaxhimi i mbetjeve	129,162	86,992	109,700	109,022	80,584	74,491	95,801	28,823
4	05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit								
5	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor								
Shuma			177,227	132,875	163,790	155,909	154,880	132,965	180,947	78,703
Buxheti total Vjetor i Bashkisë			1,238,404	869,813	1,404,695	1,245,817	1,288,081	907,707	1,482,003	461,040
Pjesa që mjedisi zë në buxhetin faktik (%)				15.3%		12.5%		14.6%	12.2%	

Burimi: Burimi i informacionit: Bashkia Lezhë

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Grafiku Nr. 4 Raporti fonde për mjedisin kundrejt buxhetit total.



Punoi: Grupi i Auditimit

Për bashkinë Lezhë shpenzimet vjetore në fakt që lidhen me mjedisin arrijnë deri në 15.3% të buxhetit. Edhe në këtë rast programet e dedikuara për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin mjedisor nuk rezultojnë me buxhetim dhe rrjedhimisht as realizim.

Tabela Nr. 3 Treguesit financiarë për mjedisin në Bashkinë Shkodër:


Në mijë lekë

Zërat	Kodi i prog.	Emertimi	2018		2019		2020		2021	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan vjetor	Fakt 8-mujori I-re
1	04240	Menaxhimi i infrastruktures së ujit dhe kullimit	58,874	24,690	83,160	46,172	54,180	29,862	39,340	14,657
2	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	20,076	6,582	28,603	13,270	30,637	11,821	30,313	6,375
3	05100	Menaxhimi i mbetjeve	238,435	125,536	208,445	159,212	235,949	131,583	197,340	290,954
4	05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit							40,446	0
5	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor								
Shuma			317,385	156,808	320,208	218,654	320,766	173,266	307,439	311,986
Buxheti total Vjetor i Bashkisë			3,342,580	2,610,086	3,677,744	2,905,585	3,682,227	2,774,974	3,588,554	1,817,691
Pjesa që mjedisi zë në buxhetin faktik (%)				6.0%		7.5%		6.2%	8.6%	

Burimi i informacionit: Bashkia Shkodër

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Grafiku Nr. 5 Raporti fonde për mjedisin kundrejt buxhetit total.



Punoi: Grupi i Auditimit

Për këtë bashki shpenzimet vjetore në fakt që lidhen me mjedisin arrijnë deri në 7.5% të buxhetit. Edhe në këtë rast programet e dedikuara për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin mjedisor nuk rezultojnë me buxhetim dhe rrjedhimisht as me realizim.

Tabela Nr. 4 Treguesit financiarë për mjedisin në Bashkinë Korçë:


Në mijë lekë

Zërat	Kodi i prog.	Emertimi	2018		2019		2020		2021	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan vjetor	Fakt 6-mujori I-re
1	04240	Menaxhimi i infrastruktures së ujit dhe kullimit	172,759	92,180	109,857	91,591	55,812	52,576	48,820	23,766
2	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	66,372	10,672	97,068	38,109	86,895	21,229	90,446	7,161
3	05100	Menaxhimi i mbetjeve	139,241	89,138	122,941	84,435	135,719	102,621	140,221	69,063
4	05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit								
5	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	1,436	1,093	1,264	1,074	2,435	2,200	2,042	803
Shuma			379,808	193,083	331,130	215,209	280,861	178,626	281,529	100,793
Buxheti total Vjetor i Bashkisë			2,080,191	1,429,565	2,142,247	1,568,040	1,908,508	1,351,199	1,930,355	688,845
Pjesa që mjedisi zë në buxhetin faktik (%)				13.5%		13.7%		13.2%	14.6%	

Burimi i informacionit: Bashkia Korçë

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Grafiku Nr. 6 Raporti fonde për mjedisin kundrejt buxhetit total.



Punoi: Grupi i Auditimit

Për këtë bashki shpenzimet vjetore në fakt që lidhen me mjedisin arrijnë deri në 13.7% të buxhetit. Ndryshe nga NJVV-të e tjera në këtë rast programet e dedikuara për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin mjedisor pavarësisht vlerave të ulëta rezultojnë me buxhetime dhe realizim të tij ndryshe nga NJVQV e tjera të analizuar.

Tabela Nr. 5 Treguesit financiarë për mjedisin në Bashkinë Pogradec:


Në mijë lekë

Zërat	Kodi i prog.	Emertimi	2018		2019		2020		2021	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan vjetor	Fakt 8-mujori
1	04240	Menaxhimi i infrastruktures së ujit dhe kullimit	13,139	8,336	14,904	10,533	14,641	9,894	15,647	3,180
2	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	24,225	16,263	17,200	17,171	24,508	18,106	34,704	8,787
3	05100	Menaxhimi i mbetjeve	28,270	1,378	28,270	408	20,000	6,889	20,000	1,975
4	05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit								
5	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor								
Shuma			65,634	25,977	60,374	28,112	59,149	34,889	70,351	13,942
Buxheti total Vjetor i Bashkisë			655,364	604,265	934,970	909,984	1,007,166	878,304	1,225,771	1,111,520
Pjesa që mjedisi zë në buxhetin faktik (%)				4.3%		3.1%		4.0%	5.7%	

Burimi i informacionit: Bashkia Pogradec

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Grafiku Nr. 7 Raporti fonde për mjedisin kundrejt buxhetit total.



Punoi: Grupi i Auditimit

Për këtë bashki shpenzimet vjetore në fakt që lidhen me mjedisin arrijnë deri në 4.3% të buxhetit. Edhe në këtë rast programet e dedikuara për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin mjedisor nuk rezultojnë me buxhetim dhe rrjedhimisht as me realizim.

Tabela Nr. 6 Treguesit financiarë për mjedisin në Bashkinë Fier:

Në mijë


lekë

Zërat	Kodi i prog.	Emertimi	2018		2019		2020		2021	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan vjetor	Fakt 10mujori
1	04240	Menaxhimi i infrastruktures së ujit dhe kullimit	83,422	60,471	75,395	57,411	68,399	48,973	68,400	34,767
2	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	3,265	2,968	3,681	3,275	3,681	3,384	4,048	2,700
3	05100	Menaxhimi i mbetjeve	149,303	142,142	154,411	140,061	147,913	139,413	188,758	128,735
5	05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit								
6	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor								
Shuma			235,990	205,581	233,487	200,747	219,993	191,770	261,206	166,202
Buxheti total Vjetor i Bashkisë			1,921,544	1,601,179	2,020,203	1,730,246	1,852,375	1,600,269	2,145,551	1,121,510
Pjesa që mjedisi zë në buxhetin faktik (%)				12.8%		11.6%		12.0%	12.2%	

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Grafiku Nr. 8 Raporti fonde për mjedisin kundrejt buxhetit total.



Punoi: Grupi i Auditimit

Për këtë bashki shpenzimet vjetore në fakt që lidhen me mjedisin arrijnë deri në 12.8% të buxhetit. Edhe në këtë rast programet e dedikuara për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin mjedisor nuk rezultojnë me buxhetim dhe rrjedhimisht as me realizim.


Tabela Nr. 7 Treguesit financiarë për mjedisin në Bashkinë Vlorë:

Në mijë lekë

Zërat	Kodi i programit	Emertimi	2018		2019		2020		2021	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan vjetor	Fakt 6-mujori I-re
1	04240	Menaxhimi i infrastruktures së ujit dhe kullimit	74,526	45,292	66,997	53,524	45,248	35,431	40,000	19,462
2	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	6,425	2,142	9,771	3,996	11,263	6,750	10,550	3,561
3	05100	Menaxhimi i mbetjeve	316,932	314,154	292,898	279,642	355,388	268,864	371,868	148,000
4	05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit								
5	05630	Ndërgjegjësimi mjedisor								
6		Tjetër/specifiko (Gjelberimi)	33,250	31,881			50,573	40,703	77,024	41,533
Shuma			431,133	393,469	369,666	337,162	462,472	351,748	499,442	212,556
Buxheti total Vjetor i Bashkisë			2,004,432	1,549,526	2,181,435	1,718,907	2,181,644	1,689,652	2,371,373	
Pjesa që mjedisi zë në buxhetin faktik (%)				25.4%		19.6%		20.8%	21.1%	

Burimi i informacionit: Bashkia Vlorë, Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Grafiku Nr. 9 Raporti fonde për mjedisin kundrejt buxhetit total.



Punoi: Grupi i Auditimit

Për këtë bashki shpenzimet vjetore në fakt që lidhen me mjedisin arrijnë deri në 25.4% të buxhetit. Edhe në këtë rast programet e dedikuara për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin mjedisor nuk rezultojnë me buxhetim dhe rrjedhimisht as me realizim.

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

“Administrimi” është e drejta për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e një funksioni. **“Autonomi vendore”** është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuader të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.

“Funksion” është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.

“Funksione të deleguara” janë ato funksione të qeverisë qendrore, ushtrimi i të cilave u delegohet njësive të vetëqeverisjes vendore.

“Kompetencë” është autoriteti i dhënë me ligj një organi të njësive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e një funksioni apo një pjesë të tij.

“Konsultimi” është proces institucional këshillimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, transparent dhe i drejtpërdrejtë, për informimin, këshillimin e shkëmbimin e opinioneve për politikën, legjislacionin e normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, i cili zhvillohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, sipas procedurave dhe një strukture të përcaktuar.

“Ndërmarrje për shërbime publike” është çdo ndërmarrje e krijuar për të ofruar shërbim/shërbime publik/e që janë kompetencë e bashkisë, për të cilën kapitali, vota ose e drejta për të emëruar organet drejtuese dhe financimi kontrollohen nga bashkia.

“Qeverisje qendrore” është Këshilli i Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të shtetit. **“Rregullimi”** është e drejta për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin.

“Riorganizim administrativo-territorial” është ndryshimi në ndarjen administrativoterritoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore.

“Subjekt i kompetencave të përbashkëta” është një komitet, ent, institucion, ndërmarrje ose bord, shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e një shërbimi ose përmbushjen e një detyrimi të përbashkët. **“Subsidiaritet”** është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efikasitetit dhe ekonomisë.

“Shërbime publike” janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.²³

“Mjedis” janë përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.

“Cilësi e mjedisit” është gjendja e mjedisit apo e një përbërësi të tij në një kohë të caktuar, e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë.

“Dëmtim i mjedisit” është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet nga njeriu ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre.

“Autoritet publik” janë: a) organet e qeverisjes qendrore dhe vendore apo organet e tjera të administratës publike, përfshirë organizmat këshillues publikë, në nivel kombëtar, rajonal apo vendor; b) çdo person, fizik apo juridik, që ushtron funksione administrative publike, përfshirë edhe detyra, veprimtari ose shërbime specifike që kanë të bëjnë me mjedisin; c) çdo person, fizik apo juridik, që ka përgjegjësi a funksione publike apo që siguron shërbime publike, që kanë të bëjnë me mjedisin dhe janë nën kontrollin e një organizmi apo personi që përfshihet në grupimet e përcaktuara në shkronjat ôa dhe ôb të pikës 1 të këtij neni.²⁴

“Kapacitet bartës” është kapaciteti i mjedisit për të pranuar ndryshimet e shkaktuara nga faktorët e jashtëm, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, vetitë e tij natyrore

“Mjedis i kërcënuar” është mjedisi i një zone të caktuar nën efektin e trysnisë së një ndotjeje të konsiderueshme.

“Ndërhyrje negative në mjedis” është çdo veprim i përkohshëm apo i vazhdueshëm i njeriut, që mund të prekë kapacitetin bartës të mjedisit apo biodiversitetin e tij, ose që ka ndikime të dëmshme mbi mjedisin.

“Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimit e tjera të ligjshme të mjedisit.

“Rrezik ndaj mjedisit” është mundësia që paraqet një veprimtari njerëzore për të shkaktuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, dëmtimin e mjedisit apo për të vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e njeriut.

²³ Ligji Nr.139/2015, Neni 2* përkufizimet Për vetëqeverisjen vendore

²⁴ Të gjitha përkufizimet i janë referuar Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 | Për mbrojtjen e mjedisit

“Skema e ekomenaxhimit dhe auditimit” është një instrument menaxhimi për organizatat e biznesit dhe organizata të tjera për të vlerësuar, për të raportuar e për të përmirësuar performancën e tyre në mjedis.

“Subjekt ndotës ose ndotës” është çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit.

“Substanca” janë elementet kimike dhe përbërjet e tyre në gjendjen e tyre natyrore apo siç prodhohen nga industria.


“Substancë e rrezikshme” është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t’u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme.

“Shkarkim” është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të veçuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë, si pasojë e veprimtarisë njerëzore.

“Grumbullim” është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.²⁵

“Krijues i mbetjeve” është çdo person, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.²⁶

“Grumbullim i diferencuar” është grumbullimi, sipas të cilit një rrymë mbetjesh ndahet, në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik²⁷.



2.6 Skema e analizës së programit auditues

Ky auditim do të fokusohet në analizimin e politikave mjedisore në NJVQV dhe efektivitetin e tyre, rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë patur duke u fokusuar veçanërisht në:

- Ngritjen e strukturave të përshtatshme nga NJVQV;
- Rolin që NJVQV kanë në lidhje me politikat qendrore mjedisore;
- Fondet buxhetore që alokohen për politika mjedisore;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi midis NJVQV dhe institucioneve qendrore;
- Sistemin e raportimit mbi politikat e ndjekura;

²⁵ Ligji Nr.10463 datë 22.09.2011, Neni 3* përkufizimet, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve

²⁶ Ligji Nr.10463 datë 22.09.2011, Neni 3* përkufizimet, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve

²⁷ Ligji Nr.10463 datë 22.09.2011, Neni 3* përkufizimet, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve

- Transparencën dhe përfshirjen e komunitetit gjatë gjithë procesit;
- Matjen e efektivitetit të politikave të hartuara;

2.7 Feedback-u i subjektit përgjatë gjithë auditimit

Gjatë fazës studimore por edhe në fazën e terrenit, Bashkitë Tiranë, Vlorë, Fier, Lezhë, Shkodër, Pogradec dhe Korçë i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve konsultuese, intervistave, si edhe plotësimit të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi subjektet gjatë fazës së terrenit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën PESTLE duke marrë në konsideratë risqet e gjashtë fushave të ndryshme në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht në nivelin politik, ekonomik, social, teknologjik, ligjor e mjedisor. Analiza PESTLE është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar.²⁸ Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë krahas risqeve që lidhen me politikat është fokusuar edhe në risqet ekonomike, sociale e mjedisore duke qenë se politikat mjedisore kanë pasojë drejtpësdrejtë në të tre këto fusha.

²⁸ www.free-management-ebooks.com, 2013 ISBN 978-1-62620-998-5

Tabela. 6: Analiza e Riskut


Burimi: Grupi i auditimit

P Political	E Economic	S Social	T Technological	L Legal	E Environment
*Zgjedhjet vendore në vitin 2019 dhe efekti zgjedhjeve parlamentare ne vitin 2021. *Kriza politike dhe efektet në përfaqësimin e plotë të spektrit politik. *Ndikimi i Pandemisë në kufizimet që mund shkaktojë *Mungesa e dokumentave strategjikë në nivel vendor	*Mungesë buxhetesh të dedikuara për politikat mjedisore *Mungesë e analizave të thelluara që mund të rezultojnë me tejkalim të buxheteve të parashikuara *Ulja e të ardhurave dhe rritja e shpenzimeve në buxhetet e NJVQV si pasojë e fatkeqësive natyrore *Kosto të larta për rehabilitimin e mjedisit në tërësi	*Ndotja dhe dëmtimi i mjedisit në tërësi ka impakt të fortë dhe ndikon cilësinë e jetës së qytetarëve. *Mungesa e konsultimit me publikun gjatë hartimit të politikave mjedisore *Mungesa e transparencës me publikun për problemet mjedisore *Mungesë e fushatave ndërgjegjësuese në funksion të mbrojtjes së mjedisit	*Aktivitete prodhuese apo tregëtare me impakt negativ në mjedis. *Përdorimi teknologjive të vjetëruara në industri të caktuara.	*Mungesa e një plan veprimi të qartë dedikuar për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me dokumentat strategjikë *Krijimi i një strukture të dedikuar për mjedisin Mungesa e kuadrit rregullator për funksionimin e strukturës së dedikuar mjedisit *Mundësia e mbivendosjes së detyrave dhe funksioneve midis NJVQV dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në çështjet mjedisore. *Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve të përfshirë në zbatimin e politikave kombëtare *Mosfunksionimi i sistemit të raportimit për çështjet mjedisore	*Pasojat e fatkeqësisë natyrore të nëntorit 2019 të cilat shkaktuan dëme në mjedis dhe ekosisteme. *Vatra të vjetra të ndotjes mjedisore të cilat nuk kanë marrë akoma zgjidhje. *Lëvizjet demografike dhe krijimi i poleve urbane.

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë óEfektiviteti i politikave mjedisore në NJVQVô ka si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv, nëse kompetencat dhe përgjegjësitë që NJVQV-të kanë në fushën e mbrojtjes së mjedisit kanë prodhuar struktura dhe politika të përshtatshme në drejtëm të mbrojtjes së mjedisit. Me anë të këtij objektivi kemi mundur të konkludojmë mbi politika mjedisore të hartuara në nivel vendor dhe deri në çfarë mase kanë qenë ato efektive.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka patur si fushëveprim analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e politikave mjedisore në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij ka patur një qasje në nivel makro duke parë nga perspektiva e detyrimeve që NJVQV-të kanë në lidhje me zbatimin e politikave mjedisore në nivel qendror nëpërmjet planeve vendore që kanë synim mbrojtjen e mjedisit. Ky auditim nuk është fokusuar specifikisht në procedura dhe procese të veçanta duke qenë se fokusi ynë ka qenë kryesisht drejt politikave të hartuara dhe implementimit të tyre. Periudha e auditimit ka qenë vitet 2018-2021. Gjatë këtij auditimi jemi fokusuar në 7 NJVQV, konkretisht Bashkitë Tiranë, Vlorë, Fier, Lezhë, Shkodër, Pogradec dhe Korçë. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhur ka qenë për të patur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit në këndvështrimin e politikave të hartuara për mjedisin dhe krahasimin e qasjes që ato kanë në varësi të specifikave mbi territorin që mbulojnë.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE / NËNPYETJEVE

Pyetja Kryesore: A kanë qenë efektive politikat mjedisore në NJVQV?

Mesazhi i auditimit

Edhe pse mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore²⁹, ajo nuk ka patur vëmendjen e duhur nga ana e NJVQV-ve subjekt auditimi. Pavarësisht përpjekjeve, për periudhën objekt auditimi, vitet 2018-2021, ka ende shumë punë për të bërë në drejtim të politikave mjedisore në nivel vendor. Thua se në të gjitha NJVQV-të e audituara mungojnë struktura të dedikuara për të prodhuar politika mjedisore, si dhe qartazi ka munguar mbështetja me fonde buxhetore. Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve, pjesë e procesit të hartimit dhe implementimit të politikave mjedisore është i ulët, dhe sistemi i raportimit në lidhje me politikat mjedisore mungon plotësisht në të gjitha NJVQV. Zërimi i plotë i politikave të nivelit qendror në politika lokale, nuk pasqyrohet në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 *ËPër mbrojtjen e mjedisit*. Edhe në rastet e pakta të politikave të ndërmarra nga disa NJVQV, nuk është kryer asnjë analizë apo vlerësim, për të matur ndikimin që këto politika sjellin në mjedis. Proceset e informimit të publikut për çështjet mjedisore, tërheqja e mendimit të tij gjatë hartimit të politikave në nivel vendor, edukimi dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve me synimin e përfshirjes së çdo anëtar të shoqërisë për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi, si përgjegjësi e të gjithëve, kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

4.1 A janë hartuar politikat e duhura mjedisore nga NJVQV?

4.1.1 A janë ngritur strukturat e duhura dhe të përshtatshme për hartimin e politikave mjedisore?

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi dhe unifikimi i masave për mbrojtjen e tij është një sfidë globale. Në vendin tonë mbrojtja e mjedisit përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore dhe për çdo banor të Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 *ËPër Mbrojtjen e Mjedisit*, trajton qëllimin për mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Në këtë ligj përcaktohen dhe detyrimet për autoritetet e qeverisjes vendore për hartimin në mënyrë periodike të planeve të veprimit referuar strategjive për secilin nga përbërësit e mjedisit.

²⁹ Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 *ËPër Mbrojtjen e Mjedisit*, neni 4.

-Ligji nr. 139/2015, óPër Vetëqeverisjen Vendoreó në nenin 3 të tij përcakton se, Vetëqeverisja Vendore në Republikën e Shqipërisë duhet të sigurojë qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore. Në nenin 9 të ligjit përcaktohet se NJVQV-të kanë të drejtën të krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi dhe nëse vlerësohet e nevojshme të krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre apo edhe komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta. Po në këtë ligj veç të tjerash sanksionohet gjithashtu përgjegjësia e këtyre njësive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, natyrës dhe biodiversitetit.

Grupi i auditimit, me qëllim vlerësimin e situatës shqyrtoi informacione e paraqitur nga subjektet e audituara Bashkitë Tiranë, Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Pogradec dhe Korçë lidhur me strukturat e dedikuara për hartimin e politikave mjedisore nga ku rezultoi se vetëm në Bashkinë Tiranë, e cila është dhe bashkia më e madhe në vend, gjendej një strukturë e dedikuar për politikën mjedisore në nivel drejtorie. Në Bashkinë Shkodër kjo njësi përfshinte edhe detyra të tjera, ndërsa në NJVQV-të e tjera detyrat për mjedisin kryheshin nga sektorë apo specialistë të ngarkuar për mjedisin, pjesë e drejtorive të ndryshme.

Gjetje:

1. Në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, përkatësisht në Bashkitë Lezhë, Fier, Vlorë, Pogradec dhe Korçë për periudhën objekt auditimi vitet 2018-2021, nuk ka patur struktura të dedikuara për hartimin e politikave mjedisore dhe monitorimin e tyre duke mos përmbushur kërkesat e nenit 3 pika ç) dhe nenit 9 pika 1.1 të ligjit nr. 139/2015 óPër Vetëqeverisjen Vendoreó dhe mos garantuar ushtrimin efektiv të funksioneve dhe kompetencave në fushën mjedisore. Çështjet që lidhen me mjedisin mbulohen nga specialistë në numër të pakët të cilët janë në përbërje të njësive të ndryshme brenda institucionit.
2. Në Bashkinë Tiranë dhe Shkodër për periudhën objekt auditimi gjenden të ngritura në nivel drejtorie brenda strukturës, njësitë për hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore. Këto struktura referuar detyrave të përcaktuara në Rregulloret e Brendshme kanë fokus mjaft të përgjithshëm dhe si pasojë nuk kanë arritur të garantojnë përmbushjen e plotë të detyrimeve për hartimin dhe monitorimin e politikave për një mbrojtje mjedisore efektive dhe një menaxhim eficient të burimeve në përputhje me nenin 8 pika 1 dhe 5, si dhe nenin 20 pika 2, të ligjit nr. 10296 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó, i ndryshuar.
3. Në aktet e brendshme rregullative të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, subjekt auditimi, punonjësit e ngarkuar për çështjet mjedisore nuk disponojnë detyra të qarta dhe të detajuara sa i përket hartimit të politikave mjedisore, mënyrës së monitorimit dhe raportimit të tyre si dhe, ndërveprimet me strukturat e brendshme të institucionit dhe atyre jashtë tij, të ngarkuara me proceset e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit.

Konkluzione:

1. Mungesa e strukturave të dedikuara në NJVQV për hartimin e politikave mjedisore dhe monitorimin e tyre ndikon negativisht në përmbushjen e detyrimeve që këto njësi kanë për hartimin e planeve të veprimit për secilin element mjedisor, monitorimit të tyre si dhe garantimin e një mbrojtje mjedisore efektive dhe eficiente, si një përparësi kombëtare.
2. Edhe pse në Bashkinë Tiranë dhe Shkodër janë ngritur strukturat për hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore, ato nuk kanë arritur të përmbushin rolin e tyre të plotë.

3. Mungesa e përshkrimeve të qarta dhe të detajuara të detyrave në aktet e brendshme rregullative të institucionit, kanë ndikime negative sa i përket hartimit të politikave mjedisore, rishikimit në kohë të tyre, monitorimit të vazhdueshëm si dhe marrjes në kohë të masave të nevojshme.

Rekomandime:

1. Bashkitë, Lezhë, Fier, Vlorë, Pogradec dhe Korçë të ngrenë strukturat e nevojshme të dedikuara për hartimin e politikave mjedisore, monitorimin e tyre si dhe për të garantuar bashkëpunimin me njësitë e tjera brenda institucionit dhe atyre ndër-institucionale, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit.

Brenda datës 31.12.2022

2. Bashkitë, Tiranë dhe Shkodër të rishikojnë strukturat ekzistuese për të bërë ato më eficiente për të ndjekur në mënyrë të dedikuar hartimin e politikave mjedisore dhe monitorimin e tyre në vazhdimësi.

Brenda datës 31.12.2022

3. Bashkitë, Tiranë, Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Pogradec dhe Korçë, të shoqërojnë ndryshimet strukturore me përmirësim dhe azhurnim të akteve të brendshme rregullative duke përcaktuar qartë detyrat dhe objektivat e njësive të dedikuara në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin përkatës.

Brenda datës 31.12.2022

4.1.2 A janë parashikuar fonde buxhetore të mjaftueshme për politikat mjedisore?

Buxheti vendor përfshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e njësisë së qeverisjes vendore. Hartimi dhe zbatimi i buxheteve përcaktohet në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Ligjin nr. 68/2017 óPër financat e qeverisjes vendore si dhe aktet nënligjore për zbatimin e tyre. Referuar treguesve buxhetorë vjetorë të planifikuar dhe realizuar në NJVQV-të objekt auditimi evidentohet se, pesha specifike që programet që lidhen me mjedisin zënë në raport me buxhetin total vjetor paraqiten si më poshtë:


Tabela 1. Pesha specifike e programeve për mjedisin/Buxheti total

Nr.	Bashkia	Periudha			
		2018	2019	2020	2021
1	Vlore	25.4%	19.6%	20.8%	21.1%
2	Lezhë	15.3%	12.5%	14.6%	12.2%
3	Korçë	13.5%	13.7%	13.2%	14.6%
4	Fier	12.8%	11.6%	12.0%	12.2%
5	Tirane	9.2%	9.4%	11.1%	10.7%
6	Shkodër	6.0%	7.5%	6.2%	8.6%
7	Pogradec	4.3%	3.1%	4.0%	5.7%

Burimi: Të dhënat nga NJVQV

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Grafiku 1. Paraqitja grafike e tendencës së fondeve buxhetore për mjedisin



Burimi: Të dhënat nga NJVQV

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Referuar këtyre treguesve, Bashkia Vlorë rezulton me peshën specifike më të lartë me buxhetet të dedikuara për mjedisin me rreth 21.7%, ndërsa Bashkia Pogradec i dedikon çështjeve mjedisore mesatarisht vetëm 4.3% të buxhetit vjetor. Theksojmë se edhe midis bashkive, dinamikat mjedisore kanë ndryshime të rëndësishme, kjo për shkak të shtrirjes territoriale, pozicionit gjeografik, numrit të popullsisë, madhësisë së qendrave urbane, problematikave specifike të mbartura etj.

Gjetje:

- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, përkatësisht Bashkitë Tiranë, Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë dhe Pogradec për periudhën objekt auditimi vitet 2018-2021, nuk kanë parashikuar fonde buxhetore të cilat lidhen dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore përkatësisht në programet buxhetore nr. 05320 óProgramet e mbrojtjes së mjedisit dhe nr. 05630 óNdërgjegjësimi mjedisor. Ndryshe nga sa më sipër, Bashkia Korçë ka parashikuar dhe realizuar shpenzime buxhetore sa i përket ndërgjegjësimit mjedisor megjithëse në nivele të ulëta. Nxitja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm është detyrë konsistente për institucionet publike e cila parashikohet, në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 óPër Mbrojtjen e Mjedisit neni 14 i tij dhe gjejnë gjithashtu pasqyrim edhe në Konventën e Åarhus³⁰, ku veç të tjerash kërkohet promovimi i tyre në vazhdimësi dhe thellimi i përgjegjësisë e transparencës në procesin e vendimmarrjes si dhe fuqizimin e mbështetjes publike për vendimet që kanë të bëjnë me fushën e mjedisit. Nga ana e NJVQV-ve mbetet ende shumë për të bërë në këtë drejtim.
- Fondet e dedikuara nga NJVQV-të subjekt auditimi për strukturat mjedisore kufizohen kryesisht në pagat e disa specialistëve, ndërsa shpenzimet e tjera për çështjet mjedisore referuar buxheteve vjetore, kanë qenë të orientuara drejtpërdrejt në shërbime. Megjithatë, për të përmbushur me efektivitet dhe eficiencë shpenzimet për mjedisin, referuar kërkesave të ligjit nr. 10296 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, nevojiten politika

³⁰ Konventa e Åarhus óMbi të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin, ratifikuar me ligjin nr. 8672 datë 26.10.2000

të qarta, objektive dhe të monitorueshme të cilat duhet të jenë të harmonizuara dhe të qëndrueshme në kohë.

Konkluzione:

4. Mungesa e fondeve buxhetore në programet e mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit mjedisor ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në hartimin dhe monitorimin e politikave dhe nuk garanton qëndrueshmërinë e tyre në kohë.

Rekomandime:

4. Bashkitë Tiranë, Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Pogradec dhe Korçë të planifikojnë fonde buxhetore për programet e "Mbrojtjes në mjedis" si dhe "Ndërgjegjësimit mjedisor" të cilat kanë ndikime pozitive të rëndësishme në planin afatgjatë, duke përfshirë edhe strukturat përkatëse për mjedisin në procesin e hartimit të projektbuxhetit vjetor të institucionit me qëllim evidentimin e qartë të produktit të kërkuar dhe efektin e pritshëm.

Brenda datës 31.12.2022

5. Bashkitë Tiranë, Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Pogradec dhe Korçë të kryejnë një strukturim të kujdesshëm të njësive të dedikuara për çështjet mjedisore duke mirë administruar burimet njerëzore ekzistuese të institucionit dhe garantuar mbështetjen buxhetore e këtyre njësive me fondet e nevojshme.

Brenda datës 31.12.2022

4.1.3 A janë zbërthyer politikat mjedisore në nivel qendror në dokumenta politike vendore?

Vendi përballë me një sërë problemesh mjedisore, të cilat evidentohen në raportet e gjendjes së mjedisit dhe në të tjera dokumente për mjedisin, të hartuara në këto vitet e fundit. Të dhënat e paraqitura nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në Raportet e Gjendjes së Mjedisit/RGJM, referojnë vlera mbi normat për disa nga elementët e mjedisit, si niveli zhurmave, cilësia e ajrit etj, elementë të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut.

Efektet shëndetësore të ndotjes së ajrit janë serioze. Një e treta e vdekjeve nga goditja në tru, kanceri i mushkërive dhe sëmundjet e zemrës, janë pasoje e ndotjes së ajrit.³¹

Si rezultat i zhvillimit të të gjitha fushave të ekonomisë dhe transportit kemi një rritje të faktorit ndotës në zonat urbane si pasojë e rritjes së numrit të makinave që ndikojnë në rritjen e shkallës së ndotjes në këto zona. Po kështu futja në vendin tonë e makinave të përdorura dhe të lëndëve djegëse të një cilësie të ulët çon në një rritje akoma më të madhe të nivelit të ndotjes në mjediset urbane³².

Referuar të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lidhur me importin e hidrokarbureve³³, sipas Buletinit Fiskal Janar-Dhjetor 2020, gjendja si më poshtë:

Tabela 2. Importi i Karburantit për periudhën 2017-2020


Periudha	Karburant i zhdoganuar Sasia në Ton
Viti 2017	400,256
Viti 2018	501,797
Viti 2019	520,200
Viti 2020	532,994

³¹ RGJM viti 2020 FQ.143

³² RGJM viti 2019

³³ <https://www.dogana.gov.al/c/171/225/291/statistika>

Grafiku 2: Paraqitja grafike e importit të hidrokarbureve në vend për periudhën vitet 2017-2020.



Burimi: Të dhënat e publikuara nga DPD

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Sipas të dhënave nga buletini zyrtar i DPD-së, tendenca e importit të karburantit edhe përgjatë vitit 2021 është në rritje, çka ndikon në mënyrë të pashmangshme në rritjen e nivelit të ndotjes në ajër.

Element tjetër i rëndësishëm i cili ka efekte negative në shëndetin e njeriut si dhe në mjedis është edhe gjenerimi i zhurmave për të cilin nevojiten masa mbrojtëse për ruajtjen e tyre në parametrat e përcaktuar dhe eliminimin e ndikimit negativ të saj në shëndetin e qytetarëve.

Bazuar në të dhënat e monitorimit të zhurmave, gjeneruar nga RGJM për vitet 2019-2021, vërehet se ka tejkalimin të normës në pothuajse të gjitha NJVQV subjekt i këtij auditimi.

Më poshtë janë disa nga të dhënat e publikuara nga AKM në faqen e saj zyrtare.

Të dhëna nga RGJM për vitin 2019

- ✓ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Tiranës.
Monitorimi i zhurmave në Tiranë për 6 mujorin e parë të vitit 2019 është realizuar në 15 stacione. Referuar të dhënave të monitoruara në 15 stacionet e Tiranës, në të gjitha stacionet kemi tejkalim të normës ditën dhe të normës natën³⁴.
- ✓ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Pogradecit.
Niveli i zhurmave ditën është më i lartë se norma në stacionin óKryqëzimi tek terminali i autobusëve ku kemi tejkalim të normës me 7.8%. Niveli i zhurmave natën e tejkalon normën në stacionin óKryqëzimi tek terminali i autobusëve ku kemi tejkalim të normës me 55%.³⁵
- ✓ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Fierit.

³⁴ Raport i gjendjes në mjedis, viti 2019 – FQ.133 AKM

³⁵ Raport monitorimi AKM VITI 2020.

Niveli i zhurmave monitorohet në 4 stacione si óKryqëzimi në hyrje me unazën, óPrefektura, óBanka (Tregu) dhe óKryqëzimi për në qytetin e Vlorës. Monitorimi i zhurmave është realizuar për *Laeq ditën* dhe *Laeq natën*, të dhënat e monitoruara janë krahasuar me normën ditën dhe natën. Të gjitha stacionet kanë paraqitur vlera më të larta se normat e lejuara.³⁶

- ✓ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Shkodrës.

Monitorimi është realizuar në dy stacione, kryqëzimi i hyrjes dhe Hotel Rozafa. Monitorimi është realizuar për dy tregues *Laeq ditën* dhe *Laeq natën*. Rezultatet e monitoruara janë krahasuar me normën ditën dhe natën. Stacionet e monitoruara në qytetin e Shkodrës referuar të dhënave të monitoruara kanë treguar re se kemi tejkalim të normës ditën dhe natën në të dy stacionet. Në stacionin óKryqëzimi i hyrjes niveli i zhurmave ditën e tejkalon normën me 6% ndërsa niveli i zhurmave natën e tejkalon normën me 14%. Ndërsa në stacionin e óHotel Rozafës niveli i zhurmave ditën e tejkalon normën me 9% ndërsa niveli i zhurmave natën e tejkalon normën me 17%.³⁷

- ✓ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Lezhës.

Niveli i zhurmave ditën dhe natën në të dy stacionet e Lezhës rezulton i lartë krahasuar me normat. Në stacionin e ó11 Janarit niveli i zhurmave ditën është 8 % më e lartë se norma, ndërsa natën 9% më e lartë se norma. Ndërsa në stacionin e óKryqëzimit të L Gurra niveli i zhurmave ditën është 11% më e lartë, ndërsa natën paraqitet 6% më e lartë se norma³⁸.

- ✓ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Korçës

Është realizuar në 3 stacione ditën si óKryqëzimi në hyrje, óTelekomi dhe óTregu i shumicës dhe 3 stacione natën si óKryqëzimi i Spitalit, óTelekomi dhe óKryqëzimi i spitalit. Referuar të dhënave të monitoruara vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën në 3 stacione dhe natën në dy stacione.³⁹

Të dhëna nga RGJM për vitin 2020:

- ✓ Nga monitorimi i cilësisë së ajrit urban nga AKM në qytetin e Korcës për periudhën 15.09.2020- 31.12.2020. Janë monitoruar treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban si: PM10, PM2.5, NO2, SO2, O3, CO dhe BTEX

Gjetje Monoksidi i Karbonit(CO) emetohet në Atmosferë për shkak të djegjes jo të plotë të lëndës djegëse. Burimet kryesor të shkarkimit të CO në ajër janë: transporti rrugor, biznesi, shtëpitë dhe industria. Monoksidi i karbonit (CO) është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemër dhe të dëmtojë sistemin nervor. Po ashtu mund të shkaktojë dhimbje kokë, marrje-mëndsh dhe lodhje. Vlerat 8 orare më të larta janë monitoruar në stacionin e Korçës në muajin Dhjetor 2020. Vlera më e lartë 8 orare është 12.13 mg/m³ në datën 15.12.2020, nga 10 µg/m³ që është norma 8 orare e BE. Nivelet më të larta të benzenit, janë monitoruar në stacionin e Korçës sidomos në periudhën Nëntor-Dhjetor.

- ✓ Niveli i zhurmave në qytetin e Tiranës. Monitorimi i zhurmave për *Laeq ditën* dhe *Laeq natën*, në qytetin e Tiranës është realizuar në 15 pika monitorimi siç paraqiten më poshtë. Kemi tejkalim të normës ditën në të gjitha stacionet me përjashtim të stacioneve óRuga e Elbasanit dhe óKryqëzimi Vasil Shanto ku nivelet e monitoruara nuk tejkalojnë normën ditën për arsye se monitorimi është kryer gjatë pandemisë. Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionet óSkënderbeu, óStadiumi Dinamo dhe óPartizani i Panjohur ku kemi tejkalim të normës ditën me 24.7%, 23.9% dhe 26.8 %. Bazuar në monitorimin e zhurmave natën në 15 stacionet e Tiranës, niveli është më e lartë se norma paraqitet në të gjitha stacionet. Niveli më e lartë është monitoruar në stacionet óLaparakë (Kryqëzimi i

³⁶ Raport i gjendjes në mjedis, viti 2019 – FQ.136 AKM

³⁷ Raport i gjendjes në mjedis, viti 2019 – FQ.140 AKM

³⁸ Raport i gjendjes në mjedis, viti 2019 – FQ.135 AKM

³⁹ Raport i gjendjes në mjedis, viti 2019 – FQ.138& 139AKM

Spitalit) ku kemi tejkalim të normës 34%, Stacioni i Trenit dhe Stadiumi Dinamo 32%, etj.

- ✓ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Lezhës.
Niveli i zhurmave ditën në të dy stacionet e Lezhës rezulton i lartë krahasuar me normën. Niveli më i lartë është monitoruar në stacionin e 11 Janarit ku kemi tejkalim të normës me 16.5%, ndërsa në stacionin e Kryqëzimit Lagja Gurra kemi tejkalim të normës ditën me 9.45%. Përsa i përket nivelit të zhurmave natën, kemi tejkalim të normës me 14.9% në stacionin e 11 Janarit.
Në të gjitha qytetet kemi tejkalimin të normës ditën (55 dB me përjashtim të Kukësit) ku niveli i zhurmave është më i ulët se norma. Nivelet më të larta janë monitoruar në stacionet e Tiranës, Lezhës dhe Shkodrës ku kemi tejkalim të normës në Tiranë 13.58%, në Lezhë 12.9% dhe Shkodër 14.8%.⁴⁰
- ✓ Përkeqësim të situatës kemi në qytetet Fier, Korçë dhe Shkodër ku kemi tendencë në rritje të nivelit të zhurmave për periudhën e natës⁴¹.

Veprimtaria monitoruese dhe vlerësimi i mjedisit mbështetet tek treguesit mjedisorë. Treguesit e prodhuar nga RGJM janë përbërës mjedisorë të domosdoshëm që përdoren për vlerësimin e prirjeve mjedisore, të dukurive të caktuara, ndjekjen në vazhdimësi, arrijtet lidhur me përmbushjen e objektivave apo afatet e vendosura. Ato gjithashtu shërbejnë për të vlerësuar efektivitetin e politikave mjedisore të caktuara dhe bërjen publike të dukurive mjedisore, për gjithë publikun jo teknik dhe të përfshirë në këto procese.

Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 Për mbrojtjen e mjedisit, ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rrezeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.⁴²

Ministria e Mjedisit përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare në mënyrë periodike sipas rastit për gjithë elementët përbërës të mjedisit, të cilat rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave. Strategjitë dhe planet kombëtare të hartuara nga Ministria e Mjedisit miratohen nga Këshilli i Ministrave⁴³.

Autoritetet e qeverisjes vendore përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare të cilat rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave. Planet e veprimit, vendore, miratohen nga Këshilli i autoritetit të qeverisjes vendore.⁴⁴

Megjithëse të dhënat e monitoruara janë shqetësuese, jo të gjitha NJVQV kanë marrë masa për të hartuar plane vendore të dedikuara për secilin element të mjedisit. Planet e dedikuara duhet të jenë të zbatueshme dhe me indikatorë të matshëm, duke siguruar edhe monitorimin e zbatimit të planit në mënyrë që të jenë eficientë në përfundim të periudhës së zbatimit të planit. Ato gjithashtu kërkojnë rishikim të vazhdueshëm, në përputhje me ndryshimet që ndodhin.

-Bashkia Tiranë ka hartuar vetëm një projekt në lidhje me politikat mjedisore Tirana e gjelbër, i cili është objekt i një auditimi tjetër dhe nuk do të trajtohet në këtë material.

Në lidhje me zbatimin e politikave të tjera në nivel qendror, nuk rezultojnë plane të tjera veprimi apo strategji lokale për mjedisin të miratuara.

⁴⁰ RGJM viti 2020 –FQ.178

⁴¹ RGJM viti 2020 –FQ.180

⁴² Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 1

⁴³ Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 21

⁴⁴ Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 22

-Bashkia Shkodër ka hartuar dhe miratuar Plane vendore për çështjet mjedisore si më poshtë:

- Plani Lokal për veprimin e zhurmave në mjedis, miratuar me VKB Nr 22 datë 18.04.2019
- Plani i mbrojtjes së biodiversitetit, miratuar me VKB Nr 16 datë 01.03.2017

-Bashkia Lezhë ka hartuar dhe miratuar me VKB Plane vendore për çështjet mjedisore si më poshtë,

- Plani lokal i veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis 2019, miratuar me VKB Nr. 44 datë 29.03.2019.

Kjo bashki ka hartuar Plane vendore për mjedisin si më poshtë, të cilat nuk janë miratuar me VKB:

- Plani për menaxhimin e mbetjeve të ngurta 2017-2021
- Plani i rishikuar vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve 2020-2024

-Bashkia Pogradec nuk ka hartuar asnjë plan vendor në lidhje me mjedisin, në përputhje me planet, strategjitë e nivelit qendror.

-Bashkia Korçë nuk ka hartuar asnjë plan vendor në lidhje me mjedisin, në përputhje me planet, strategjitë e nivelit qendror.

-Bashkia Vlorë nuk ka hartuar asnjë plan vendor në lidhje me mjedisin, në përputhje me planet, strategjitë e nivelit qendror.

-Bashkia Fier nuk ka hartuar asnjë plan vendor në lidhje me mjedisin, në përputhje me planet, strategjitë e nivelit qendror.

Gjetje

6. Bashkitë Tiranë, Fier, Vlorë, Pogradec, Korçë, nuk kanë hartuar plane veprimi vendore për elementë të mjedisit, të cilat më pas të rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave, në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare duke mos përmbushur kërkesat ligjore përcaktuar në Ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit, neni 22, pika 1 e tij. Edhe në rastet kur elementë të caktuar të mjedisit kanë qenë në nivel shqetësues, sipas raportimeve publike të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nuk evidentohen plane veprimi konkrete nga ana e NJVQV-ve në drejtim të përmirësimit të tyre. Konkretisht, sipas raportimeve të AKM evidentohet tejkalim i normave të lejuara për disa nga elementët e mjedisit, si niveli i zhurmave të matura në këto njësi vendore për vitet 2019-2020 dhe prezenca e lartë e Monoksidit të Karbonit (CO) në ajër specifikë e Bashkisë Korçë, faktorë të cilët ndikojnë negativisht në shëndetin e qytetarëve.
7. Në ndryshim nga NJVQV-të e tjera Bashkia Shkodër dhe Lezhë, kanë zbërthyer disa nga strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit për mjedisin duke hartuar dhe miratuar planet vendore të veprimit. Pavarësisht hapave të ndërmarrë, këto bashki nuk kanë hartuar plotësisht planet e veprimit vendore, për të gjithë elementët e mjedisit që parashikohen nga politikat kombëtare. Mungesa e planeve vendore në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare të cilat rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, bie ndesh me kërkesat ligjore përcaktuar në Ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit, neni 22, pika 1.

8. Bashkia Lezhë, ka hartuar óPlanin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2024, të rishikuar, i cili nuk është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, duke mos përmbushur kërkesat ligjore përcaktuar në Ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit, neni 22, pika 3.

Konkluzione:

5. Mungesa e planeve të veprimit në nivel vendor për mjedisin në përputhje me strategjitë dhe planet e miratuar në nivel qendror nga Këshilli i Ministrave, ndikon negativisht në parandalimin e dëmtimit të elementëve të mjedisit dhe rrezikon të çënojë mbrojtjen e mjedisit në tërësi.
6. Mungesa e planeve specifike të veprimit në disa NJVQV, në të cilat normat e monitoruara nga AKM i tejkalojnë normat e lejuara specifike, krijojnë mundësi për dëmtime të mëtejshme të elementëve të mjedisit duke ndikuar negativisht në shëndetin e qytetarëve.
7. Planet dhe strategjitë kombëtare jo vetëm duhen zbërthyer nga NJVQV-të në dokumente politike, vendorë por kërkojnë edhe rishikim të vazhdueshëm, në mënyrë që të ruhen parametrat brenda normave të lejuara, në varësi të dinamikave të zhvillimit mjedisor.
8. Duhet sjellë në vëmendje se elementë të caktuar të mjedisit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komunitetit. Për më tepër duke konsideruar se: Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.⁴⁵, NJVQV-të duhet të japin rëndësinë e duhur hartimit dhe zbatimit të politikave mjedisore.

Rekomandime:

6. Bashkitë Tiranë, Shkodër, Lezhë, nëpërmjet strukturave të dedikuara për çështjet mjedisore, të marrin masa për hartuar plane veprimi vendore, për mjedisin, në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare si përcaktohet në Ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit, neni 22, pika 1 e tij.

Brenda datës 31.03.2023

7. Bashkia Lezhë të marrë masa për miratimin me Vendim të Këshillit Bashkiak, të óPlanit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2024, i rishikuar, si përcaktohet në Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit, Neni 22, pika 3.

Brenda datës 30.09.2022

8. Bashkitë Fier, Vlorë, Pogradec, Korçë nëpërmjet strukturave të dedikuara për çështjet mjedisore, të marrin masa për të plotësuar hartimin e planeve të veprimit, vendore për mjedisin, në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare si përcaktohet në Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit, Neni 22, pika 1.

Brenda datës 31.03.2023

4.2 A rezulton pozitive dinamika e politikave të ndërmarra nga NJVQV?

⁴⁵ Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 4

4.2.1 A kanë arritur objektivat e parashikuar politikat e ndërmarra?

Si është trajtuar edhe më sipër, ka patur shumë pak dokumenta politikë të prodhuar nga NJVQV në lidhje me mjedisin të cilat trajtohen më poshtë.

-Bashkia Tiranë ka hartuar vetëm një projekt në lidhje me politikat mjedisore óTirana e gjelbërô, i cili është objekt i një auditimi tjetër dhe nuk do të trajtohet në këtë material.

Në lidhje me zbërthimin e politikave të tjera në nivel qendror, nuk rezultojnë plane të tjera veprimi apo strategji lokale për mjedisin të miratuara.

-Bashkia Shkodër ka hartuar dhe miratuar Plane vendore për mjedisin si më poshtë:

- Plani i mbrojtjes së biodiversitetit, miratuar me VKB Nr 16 datë 01.03.2017
- Plani Lokal për veprimin e zhurmave në mjedis, miratuar me VKB Nr 22 datë 18.04.2019

-Bashkia Lezhë ka hartuar dhe miratuar me VKB Plane vendore për mjedisin si më poshtë,

- Plani lokal i veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis 2019, miratuar me VKB Nr. 44 datë 29.03.2019.

-Bashkia Lezhë ka hartuar Plane vendore për mjedisin si më poshtë, të cilat nuk janë miratuar me VKB:

- Plani për menaxhimin e mbetjeve të ngurta 2017-2021
- Plani i rishikuar vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve 2020-2024

Sipas Agjencisë Europiane të Mjedisit, cikli politik për hartimin e një vendimmarrje të duhur dhe nevojshme duhet të kalojë në gjashtë faza si vijon:

- 1- *Njohja e shqetësimit;*
- 2- *Përkufizimi i shqetësimit;*
- 3- *Njohja e politikave që nevojiten për trajtimin e tij;*
- 4- *Përpilimi i politikave;*
- 5- *Zbatimi i politikave të hartuara;*
- 6- *Matja e ndikimit të këtyre politikave.*

Nga evidencat e grumbulluar gjatë auditimit, përgjigjet e pyetësorëve, intervistat etj, nuk rezultojnë analiza të kryera nga bashkitë lidhur me politikat e ndërmarra, matje të impaktit që këto politika kanë sjellë apo analiza të indikatorëve. Të gjithë planet e veprimit që janë prodhuar nga këto institucione rezultojnë të jenë të pamonitoruar sa i takon njësive përgjegjëse apo matjes së indikatorëve si dhe nuk janë kryer raportime në institucionet përgjegjëse, duke shkaktuar në këtë mënyrë mungesën e matjes së efektivitetit të tyre.

Gjetje:

9. Bashkitë Shkodër dhe Lezhë, nuk kanë kryer matjen e ndikimit të politikave të ndërmarra në mjedis sipas përcaktimit të ciklit politik për hartimin e një vendimmarrjeje dhe nuk kanë kryer rishikimin e planeve të veprimit, sikundër e përcakton Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisitô, neni 22 pika 2.

Konkluzione:

9. Mungesa e analizës së planeve të veprimit të ndërmarra përbën risk të lartë për mos arritjen e objektivave të caktuar.
10. Mungesa e monitorimit të planit të veprimit mund të ketë si pasojë mos ushtrimin e përgjegjësisë nga ana e njësive përgjegjëse.

11. Mungesa e matjes së indikatorëve mund të çojë në mos arritjen e objektivave të parashikuar, për rrjedhojë në mungesë të efektivitetit të politikës së ndërmarrë.

Rekomandime:

9. Bashkitë Shkodër dhe Lezhë të analizojnë statusin e planeve të veprimit dhe të krijojnë sistemin për matjen e indikatorëve, duke matur në këtë mënyrë ndikimin që këto politika kanë në mjedis në përputhje me përcaktimin e ciklit politik për hartimin e një vendimmarrjeje të duhur.

Brenda datës 31.12.2022

10. Bashkitë Shkodër dhe Lezhë, pas analizës së kryer për politikat e ndërmarra, dhe pas përfundimit të matjes së impaktit nëpërmjet procesit të vlerësimit, të konsiderojnë mundësinë e rishikimit të planeve të veprimit.

Brenda datës 31.12.2022

4.2.2 Si ka qenë niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit midis NJVQV dhe aktorëve të tjerë të përfshirë?

Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre, sigurojnë mënyrën dhe kushtet e bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit. Ministria është organi qendror i ngarkuar me ligj për përgatitjen e strategjive dhe planeve mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit, të cilat më pas miratohen nga Këshilli i Ministrave. Autoritetet e qeverisjes vendore më tej, kanë detyrimin të përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë e miratuara. Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë hartimit e miratimit të politikave për Mbrojtjen e Mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm. Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron sistemin e informacionit mjedisor, si dhe është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit. Referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 10431/2011, *ÓPër Mbrojtjen e Mjedisit*, NJVQV-të gëzojnë të drejtën e këshillimit për zbatimin e politikave mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Gjithashtu NJVQV kanë si detyrim ligjor për të siguruar që publiku dhe palët e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e të programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësit e mjedisit.

Gjetje:

10. Në NJVQV-të e audituara evidentohet se, niveli i bashkëveprimit institucional me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit është i ulët dhe ekzistent vetëm në trajtime problematikash të veçanta apo kërkesash për interpretim të akteve ligjore, ndërkohë që nuk ka një koordinim të plotë dhe të mirë strukturuar, duke mos përmbushur kërkesat e ligjit nr. 10431/2011, *ÓPër Mbrojtjen e Mjedisit* neni 11 i tij *ÓParimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit*.
11. Mungesa e strukturave të dedikuara për çështjet mjedisore në disa prej Njërive të Vetëqeverisjes Vendore objekt auditimi si dhe mosazhurnimi i akteve të brendshme rregullative me detyra të qarta, nuk ka ndihmuar në zhvillimin e një koordinimi të qëndrueshëm dhe proaktiv mbi çështjet mjedisore si dhe matjen e impaktit të tyre.

Konkluzione:

12. Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve institucionalë në fushën e mjedisit krijon risk për aplikim të pjesshëm apo keq implementim të politikave mjedisore, referuar strategjive kombëtare të miratuara, si dokumenti politik strategjik për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe plani veprimit, strategjia kombëtare për cilësinë e ajrit dhe mjedisit, plani kombëtar i veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis, etj.

Rekomandime:

11. Bashkitë Tiranë, Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Pogradec dhe Korçë nëpërmjet strukturave të dedikuara të koordinojnë veprimtarinë e tyre me AKM dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit sa i përket zbatimit të politikave dhe implementimit të tyre për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Menjëherë në vazhdimësi

4.2.3 A ka funksionuar sistemi i raportimit mbi politikat mjedisore nga ana e NJVQV?

Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë hartimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm.⁴⁶

Ligji për mjedisin përcakton se, Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.⁴⁷

Nga evidenca e grumbulluar gjatë fazës së terrenit, përgjigjet e pyetësorëve dhe intervistat me subjektet rezulton se sistemi i raportimit nuk ka funksionuar në asnjë prej subjekteve nën auditim.

Gjetje:

12. Bashkitë Tiranë, Shkodër, Lezhë, Fier, Vlorë, Korçë, Pogradec, nuk kanë raportuar në Këshillat e Qarqeve përkatës, në fillim të çdo viti, për zbatimin e planeve vendore për mjedisin, për vitin pararendës, duke mos përmbushur kërkesat ligjore përcaktuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", neni 22, pika 4.

Konkluzione:

13. Mosfunksionimi i sistemit të raportimit lidhur me politikat mjedisore mund të sjellë si pasojë mungesë të efektivitetit të politikave të ndjekura dhe mos arritjen e objektivave të parashikuara.

Rekomandime:

12. Bashkitë Tiranë, Shkodër, Lezhë, Fier, Vlorë, Korçë, Pogradec të marrin masa që të raportojnë pranë Këshillit të Qarkut përkatës, për zbatimin e planeve vendore për mjedisin,

⁴⁶ Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Neni 11, Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

⁴⁷ Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Neni 22, pika 4

në mënyrë që të rrisin transparencën e të garantojnë llogaridhënien me synim efektivitetin e politikave të ndërmarra.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4.2.4 A kanë ndërmarrë fushata ndërgjegjëse për komunitetin NJVQV?

Shkalla e ndërgjegjësimit mjedisor të publikut dhe të komunitetit të biznesit nuk është ende në nivelin e duhur. Me gjithë përpjekjet e deritanishme, roli i NJVQV-ve edhe pse është rritur nga viti në vit, nuk ka ndikimin e duhur në ndërgjegjësimin e publikut. Aksesit në informacionin mjedisor vijon të jetë problematik, me gjithë zhvillimet pozitive të kuadrit ligjor.

NJVQV-të duhet të publikojnë në faqen zyrtare të internetit si dhe të afishojnë në stendën e njoftimeve publike, çdo akt administrativ të prodhuar prej tyre. Vlen për t'u theksuar fakti se njësitë e qeverisjes vendore duhet të garantojnë akses për të gjithë, veçanërisht për shtresat më të varfëra të komunitetit. Ky parashikim e bën më të qartë faktin se njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund ta konsiderojnë të përmbushur detyrimin për bërjen publike të informacionit vetëm duke e publikuar në faqen e internetit, por duhet të ndërmarrin veprime të tjera aktive për të përçuar informacionin edhe tek ajo pjesë e komunitetit që e ka të pamundur aksesin në faqen zyrtare të institucionit.

E drejta për informim për çështjet mjedisore është bazike për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në të mirë të publikut. Ndërkohë që institucionet publike kanë detyrimin ligjor të marrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, depërtimi i informacionit mjedisor deri tek qytetarët është pjesa më e rëndësishme për ta konsideruar të përmbushur qëllimin e përbashkët për mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e kushteve mjedisore të shëndetshme për çdo individ.

Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisitô, neni 46, óInformimi i publikut në lidhje me çështjet mjedisore ó, parashikon format e publikimit dhe llojin e tyre nga ana e autoriteteve publike përkatëse.

Informacioni mjedisor përfshin çdo informacion të paraqitur në formë audioje, vizuale, elektronike, me shkrim ose në ndonjë mënyrë tjetër në lidhje me:

a) gjendjen e përbërësve të mjedisit, të tillë si: ajri dhe atmosfera, uji, toka, peizazhi dhe zonat natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare e detare, diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, përfshirë Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht, dhe ndërveprimin ndërmjet tyre;

b) faktorë të tillë, si substancat, energjia, zhurmat, rrezatimi, vibracionet, erërat e pakëndshme apo mbetjet, përfshirë mbetjet radioaktive, shkarkimet në ajër dhe ujë, si dhe shkarkime të tjera në mjedis, të cilat kanë ose mund të kenë ndikim mbi përbërësit e mjedisit, të referuar në shkronjën óaô të kësaj pike;

c) masa të tilla, si politikat, legjislacioni, planet, programet, marrëveshjet mjedisore, si dhe veprimtaritë që kanë ose mund të kenë ndikim mbi përbërësit dhe faktorët e 17 referuar në shkronjat óaô dhe óbô të kësaj pike, si dhe masat apo veprimtaritë e përcaktuara për të mbrojtur këta përbërës;

ç) raportet në lidhje me zbatimin e legjislacionit mjedisor;

d) analizat kosto-përfitime dhe analiza të tjera ekonomike, si dhe parashikimet e përdorura brenda kuadrit të masave dhe veprimtarive, të referuara në shkronjën ócô të kësaj pike;

dh) gjendjen dhe sigurinë e shëndetit të njeriut, përfshirë ndotjen e zinxhirit ushqimor, atje ku është e nevojshme, kushtet e jetesës, objektet me vlera kulturore dhe arkeologjike, si dhe strukturat e ndërtuara, për sa kohë që ato ndikohen apo mund të ndikohen nga gjendja e përbërësve të mjedisit, të referuar në shkronjën óaô të kësaj pike, ose nga ndikimi në ato përbërës të secilës prej çështjeve të referuara në shkronjat óbô dhe ócô të kësaj pike.⁴⁸

⁴⁸ Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisitô, Neni 46

VKM Nr.16, datë 4.1.2012, óPër të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisoró, Kreu II pika 2 citon:

Vënia dhe shpërndarja e informacionit të disponueshëm në shërbim të publikut realizohen, si më poshtë vijon:

a) Autoriteti publik përkatës vë në shërbim të publikut dhe ia shpërndan atij informacionin e mëposhtëm të cilin disponon:

- ✓ Politikat, strategjitë, planet dhe programet që lidhen me mjedisin;
 - ✓ Raportet për gjendjen e mjedisit;
 - ✓ Të dhënat ose përmbledhjen e të dhënave të mbledhura nga monitorimi i veprimtarive që ndikojnë ose që mund të ndikojnë në mjedis;
 - ✓ Studimet për ndikimin mjedisor dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me elementet mjedisore, siç janë ajri dhe atmosfera, uji, toka, vendet piktoreske dhe natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare, zonat e mbrojtura, diversiteti biologjik dhe përbërësit e tij, duke përfshirë këtu edhe organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe ndërveprimin midis këtyre elementeve, ose një referencë se ku mund të kërkohet ose të gjendet ky informacion.
- b) Autoriteti publik është i detyruar të përditësojë informacionin mjedisor të përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike.
- ✓ Shpërndarja e informacionit mjedisor, në rastin e kërcënimeve të pashmangshme, realizohet, si më poshtë vijon:
 - ✓ Autoriteti publik, kur gjykon se ekziston një kërcënim i pashmangshëm për shëndetin e njerëzve apo mjedisin, i shkaktuar nga veprimtaria njerëzore apo si pasojë e shkaqeve natyrore, ia shpërndan menjëherë dhe pa vonesë publikut, që ndikohet apo mund të ndikohet nga ky kërcënim, të gjithë informacionin që disponon, me qëllim që publiku të marrë masa për të shmangur ose minimizuar dëmin e mundshëm dhe pasoja negative

Autoritetet publike, fusha e veprimit të të cilave përfshin funksione të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, brenda kompetencave të tyre, nxitin informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Nga evidenca e auditimit vetëm faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër dhe Tiranë përmban informacion të pjesshëm mbi mjedisin, ndërsa në faqet zyrtare të NJVQV të tjera nuk rezulton informacion i tillë, cka kufizon publikun të informohet mbi parametrat e elementëve të caktuar të mjedisit dhe politikat e ndërmara në lidhje me përmirësimin e tyre.

Edhë në faqet ku ekziston ky informacion ai është i pamjaftueshëm dhe nuk përmban një informacion të saktë lidhur me elementë të caktuar të mjedisit, të cilët në disa raste rezultojnë mbi normat e lejuara,(përmendim rastin e ndotjes akustike e cila në të gjitha NJVQV rezulton mbi normën sipas matjeve të kryera nga AKM).⁴⁹

Pjesëmarrja e publikut në hartimin e politikave, startegjive, rajonale e kombëtare, të përgjithshme a sektoriale, dhe të planeve të veprimit, në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumentave, që përmirëson përmbajtjen dhe lehtëson zbatimin e tyre.⁵⁰

Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor është parashikuar si zë i veçantë në programet buxhetore për NJVQV. Nga evidenca e grumbulluar gjatë auditimit rezulton se asnjë nga NJVQV, subjekt i këtij auditimi nuk ka parashikuar fonde buxhetore për këtë zë të vecantë të buxhetit, fakt i cili nuk lejon të ndërmeren fushtat ndërgjegjësimi sic parashikohet.

⁴⁹ Raporti monitorimit AKM viti 2020

⁵⁰ VKM Nr.994, datë 02.07.2008 Pwr twrheqjen e mendimit tw publikut nw vendimarrje pwr mjedisin, Kreu II

Gjetje:

13. Sa i takon publikimit në faqen zyrtare të informacionit në lidhje me çështje mjedisore, rezultoi se: (i) Bashkitë Tiranë dhe Shkodër kanë publikuar në faqen e tyre zyrtare të internetit informacion jo të plotë dhe jo të përditësuar; (ii) ndërsa Bashkitë Lezhë, Fier Vlorë, Pogradec, Korçë nuk kanë publikuar asnjë të dhënë, duke mos i siguruar publikut mundësinë për të marrë informacionin mjedisor që këto bashki disponojnë, sikundër e kërkon VKM Nr.16, datë 4.1.2012 óPër të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisorô, Kreu II pika 2 si dhe Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisitô, neni 46, pika 2.
14. Niveli i ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për çështjet mjedisore rezultoi të jetë i ulët në Bashkitë Tiranë, Shkodër Lezhë, Fier Vlorë, Pogradec, Korçë, duke mos nxitur informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, sikundër e dikton Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisitô, Neni 14, pika 2.
15. Bashkitë Tiranë, Shkodër Lezhë, Fier Vlorë, Pogradec, Korçë, edhe pse kanë kryer disa hapa për të siguruar pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje lidhur me politikat mjedisore ose çështje të lidhur me të, nuk kanë përdorur të gjithë instrumentat nxitës për të siguruar pjesëmarrje proaktive, duke mos përmbushur kërkesat ligjore të përcaktuara në VKM Nr.994 datë 02/07/2008 óPër tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisinô, Kreu II, pika 1.

Konkluzione:

14. Mungesa e të dhënave në faqet e internetit të NJVQV-ve, cënon edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për çështjet mjedisore.
15. Niveli i ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për çështjet mjedisore është multidimensional dhe nuk mund të reduktohet vetëm në ditë të caktuara që lidhen me mjedisin në takime me nxënës shkollash por duhet të shtrijë dimensionet e veta sa më shumë në komunitet, duke e kthyer në mision edukimin dhe ndërgjegjësimin mjedisor.
16. Garantimi i pjesëmarrjes së gjerë të publikut në vendimmarrje ndihmon në krijimin e politikave më efektive.
17. Mungesa e përditësimit, qartësisë së informacionit, transparencës dhe koordinimit mes institucioneve cënon menaxhimin e informacionit mjedisor.

Rekomandime:

13. Bashkitë Tiranë, Shkodër, Lezhë, Fier Vlorë, Pogradec dhe Korçë të marrin masa që të plotësojnë, pasurojnë dhe përditësojnë faqen e tyre zyrtare të internetit, me informacionin e nevojshëm lidhur me çështjet mjedisore, në mënyrë që të sigurohet informimi i publikut.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14. Bashkitë Tiranë, Shkodër Lezhë, Fier Vlorë, Pogradec, Korçë të marrin masa për të rritur nivelin e edukimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor nëpërmjet të gjitha formave, në mënyrë që të zgjerojnë spektrin e publikut dhe të synojnë gjithpërfshirjen e komunitetit në këto procese.

Në vazhdimësi

15. Bashkitë Tiranë, Shkodër Lezhë, Fier Vlorë, Pogradec, Korçë të marrin masa për të rritur pjesëmarrjen e publikut në dëgjesa publike, duke përdorur gjithë instrumentet e duhur, gjatë

proceseve të hartimit dhe rishikimit të politikave vendore, me synimin që të rritin efektivitetin e politikave të ndërmarra dhe sensibilizimin e publikut për çështjet mjedisore.

Në vazhdimësi

5. PËRMBLEDHJE

Objekti kryesor i këtij auditimi ka qenë vlerësimi i politikave mjedisore gjatë periudhës vitet 2018-2021 në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe efektiviteti i tyre. Fokusi kryesor i auditimit ka qenë analizimi i strukturave pranë tyre, të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe implementimin e politikave mjedisore, detyrimin që këto struktura kanë lidhur me zbatimin e dokumentave politikë qendror në plane veprimi apo strategji vendore si dhe mbështetjen e implementimit të tyre me fonde buxhetore të nevojshme. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse janë përdorur dhe menaxhuar burimet e duhura për hartimin e politikave mjedisore dhe nëse janë arritur rezultatet e dëshiruara. Me anë të këtij objekti kemi konkluduar se deri në çfarë mase kanë qenë efektive veprimtaria e NJVQV-ve subjekt auditimi lidhur me politikat mjedisore. Në vlerësimin tonë si auditues të jashtëm të pavarur, masat e marra nga NJVQV-të për ngritjen e strukturave të përshtatshme, për hartimin dhe implementimin e politikave mjedisore, si dhe mbështetjen e tyre me fonde buxhetore, nuk kanë qenë efektive.

Gjetjet e këtij auditimi kanë prekur elementë që kanë të bëjnë me zbatimin e kornizës ligjore dhe për këtë është përdorur si kriter kryesisht Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit. Grupi i auditimit ka gjeneruar gjetje që prekin detyrimin e subjekteve për ngritjen e strukturave të përshtatshme për hartimin e politikave mjedisore si edhe mbështetjen e tyre me fonde buxhetore si një hap i parë që do të ndikonte pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit. Mangësitë e evidentuara u referohen proceseve të hartimit, miratimit dhe implementimit politikave mjedisore, mungesës së matjes së impaktit dhe raportimit të tyre në organet e përcaktuara në ligj. Një raport i ngushtë bashkëpunimi dhe koordinimi mes aktorëve të përfshirë do të shërbente pozitivisht në këtë proces. Një tjetër aspekt i trajtuar ka qenë edhe përfshirja e publikut në proceset e hartimit të politikave si një faktor shumë i rëndësishëm si dhe shkalla e edukimit dhe ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me çështjet mjedisore i cili nuk paraqitej në nivelin e dëshiruar. Në përfundim janë gjeneruar gjetje të cilat theksojnë mangësi dhe mos arritje të objektivave të subjekteve nën auditim për të cilat janë dhënë rekomandime specifike shoqëruar me afatet kohore për zbatimin e tyre.

6. SHTOJCAT

Shtojca 6.1 Observacione nga subjektet e audituara

Në mbështetje të neneve 26 dhe 29 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 óPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda 1 (një) muaji nga dita e marrjes së Projekt Raportit të Auditimit, Bashkia Korçë me anë të shkresës me nr. 7736/3 prot. datë 06.05.2022 dërgoi në KLSH komente mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës me temë óEfektiviteti i politikave mjedisore në NJVQV. Në përgjigje të Projekt Raportit të Auditimit, Bashkia Korçë nuk ka shprehur asnjë kundërshti në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e lëna. Në përmbajtjen e shkresës citohet; *“Personat përgjegjës pasi u njohën me materialin nuk kanë komente dhe shpjegime lidhur me gjetjet e auditimit”*.

Gjithashtu në përgjigje të Projekt Raportit të Auditimit, Bashkia Fier me shkresën nr. 8541/2 datë 11.05.2022, ka shprehur gadishmërinë për të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve që do të jenë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri në përmbushjen e afatit 1(një) muaj nga dita e marrjes së Projekt Raportit të Auditimit, veç Bashkisë Korçë dhe Fier, subjektet e tjera pjesë e auditimit nuk kanë dërguar observacione lidhur me materialin.